



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.1 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L – 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

K O N K U R S

Departamenti:	Për Komunikim me Publikun
Titulli:	Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave
Nr. Ref:	RN00005552
Kategoria Funktionale:	Niveli i koeficienteve
Koeficienti:	7 (shtatë)
Lloji i Pozitës:	i Karrierës
Orët e Punës:	40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit:	Nëpunës i karrierës
Vendi i punës:	Rr. Ahmet Krasniqi 210 (selia e Zyrës Kombëtare të Auditimit)
Qëllimi i vendit të punës:	Përkrahja profesionale në fushën e komunikimit dhe informimit me institucionet tjera, publikun, mediat dhe palët tjera të interesit
I përgjigjet:	Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Ofron përkrahje profesionale për ZKA-në në fushën e komunikimit dhe informimit;
2. Përgatitë konferenca për medie, përgatitë njoftime për shtyp, deklarata, raporte dhe publikime në medie;
3. Përgatitë takime dhe forume me shoqërinë civile për marrjen e imputeve lidhur me auditimin;
4. Përditëson faqen elektronike zyrtare të ZKA;
5. Koordinon aktivitetet lidhur me publikimin e raporteve të auditimit;
6. Përcjellë shkrimet dhe publikimet e mediave lidhur me aktivitete dhe shërbimet e ZKA-se dhe përgatitë përgjigjet, reagimet sipas nevojës;
7. Monitoron në vazhdimësi mediat e shkruara dhe elektronike dhe përgatitë një përmbledhje të informatave për menaxhmentin e lartë të ZKA-se;
8. Ndihmon mbikëqyrësin dhe në përgatitjen e kumtesave, informatave, raporteve dhe publikimeve tjera për publikun;
9. Mirëmban, ruan dhe arkivon të gjitha kumtesat, informatat, raportet dhe publikimet tjera për publikun të ministrisë si dhe shkrimet e mediave të shkruara dhe elektronike për ZKA-ne;
10. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkua:

- Diplomë universitare, fakulteti i gazetarisë ose në ndonjë fushë të përafërt, 2 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit publik dhe të gjuhës angleze;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion kohor;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Zyra Kombëtare e Auditimit/ Rr. Ahmet Krasniqi 210 Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Burimeve Njerëzore, tel: 038/606-004/1004 ose 038/606-004/1005, prej orës 08:00 – 16:00. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe tabelën e shpalljeve në gazetën ditore

“Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të shqyrtohen, kurse aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen”.

“Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.” “Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Aplikacionit duhet t’i bashkangjiten:

- Formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjet e diplomave për kualifikimet shkollore. Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- Kopjet e kualifikimeve të tjera profesionale;
- Dëshmitë për përvojën e punës të lëshuara nga organizata përkatëse.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.